REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

K R Y E T A R I

Nr. 3201 Prot., Maliq, më 20.06.2025

PROJEKT-VENDIM - Nr. 13

"Për dhënie ndihme financiare të menjëhershme familjeve në nevojë"

Bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 29, ligjin nr. 45/2019 *"Për Mbrojtjen Civile"*, neni 30, gërma '**gj**' dhe neni 41, pika '**2**' , VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore si dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"*, Kreu III pika 1- Procedura e vlerësimit të dëmeve germa *"a"* dhe *"ë"*, për rastin e rënies së zjarrit në banesën e z. Vilaet Ferataj, banues në fshatin Strelcë, njësia Administrative Gorë, bashkia Maliq;

i kërkoj Këshillit të Bashkisë Maliq:

1.Të miratojë një ndihmë financiare prej 961,000lekë, për familjen e z. Vilaet Ferataj, të cilit i'u dogj banesa më datën 07.06.2025 - ku vlera e plotë e dëmit të shkaktuar në banesë nga ana ndërtimore është *1,099,053* lekë *(vlera prej 50 % është **549,526** lekë)*. Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake është ***412.000*** lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **961,526** lekë.

2. Pagesa do të bëhet nga Programi i Mbrojtjes Civile si më poshtë:

Gr.	Kap.	Kod.Prog.	Llog.Eko.	Vlera (000)
17	01	10910	604	961

3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit të bazueshmërisë ligjore nga institucioni i Prefektit Korçë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË K.R. BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE KRIZAVE

Maliq, më datë 18.06.2025

3201

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e z. Vilaet Ferataj të cilit i është djegur banesa e tij si pasojë e rënies së zjarrit.

Në datën 07.06.2025, ora 10:40 u dogj banesa e z. Vilaet Ferataj, banues në fshatin Strelcë, Njësia Administrative Gorë, bashkia Maliq dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore*", sipas përcaktimit në Kreun III, pika1, gërma *"b"*, Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 282, datë 12.06.2025, shkoi në banesë dhe përgatiti procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën *1.099,053* lekë (*50% e vlerës e barabartë me **549,526** lekë*).Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është *412.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **961,526** lekë. Mbështetur në preventivat sa më sipër i propozohet Këshillit të Bashkisë për dhënien e ndihmës financiare si më poshtë:

Ti jepet një ndihmë financiare z. Vilaet Ferataj për dëmet nga ana ndërtimore në një shumë prej ***549,526*** lekë, pajisje dhe orendi elektroshtëpiake në një shumë prej *412.000* lekë. Totali për t'u dëmshpërblyer është **961,526** lekë.

Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"neni 29, ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr.329, datë 16.05.2012;*

Vendimit nr. 130, datë 26.12.2024 *"Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025".*

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	R.Mara		18.06.2025
	Ll.Kotmillshi		18.06.2025
Përgjegjës Sektori:	S. Belishta		18.06.2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Maliq, më datë 18.06.2025

3201

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e z. Vilaet Ferataj të cilit i është djegur banesa e tij si pasojë e rënies së zjarrit në banesën e tij.

Në datën 07.06.2025, ora 12:42, u dogj banesa e z. Vilaet Ferataj, banues në fshatin Strelcë, njësia Administrative Gorë, bashkia Maliq dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore, si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore"*, sipas përcaktimit në Kreun III, pika 1, gërma *"b"* Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 282, datë 12.06.2025 shkoi në banesë dhe përgatiti procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën *1.099,053* lekë (*50% e vlerës e barabarte me **549, 526 lekë***). Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është *412.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **961,526** lekë.

Mbështetur në preventivat e mësipërme dhe aftësitë financiare të Autoritetit Vendor i kërkojmë Drejtorisë të Financës dhe Buxhetit të akordojë ndihmën financiare të menjëhershme për familjen e z. Vilaet Ferataj të cilit i'u dogj banesa si pasojë e rënies së zjarrit dhe jeton në kushte të vështira ekonomike. Lidhur me situatën, mbulimi i dëmit të shkaktuar për familjen e z. Vilaet Ferataj të bëhet nga fondi i Mbrojtjes Civile në Bashki në vlerën **961,526** lekë.

Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore", neni 29,ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012:*

- Vendimit nr. 130, datë 26.12.2024 *"Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025".*

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi :	R.Mara		18.06.2025
	LI.Komilloshi		18.06.2025
Përgjegjës Sektori :	S. Belishta		18.06.2025
Përgjegjës Sektori Juridik	J. Thomo		18.06.2025
Drejtore e Financës dhe Buxhetit :	A. Muka		18.06.2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Maliq Dt. 16.06.2025

Objekti: Rikonstruksioni i Shtepisë së Djegur
Pronari: Vilaet Feratai
Vëndndodhja: Fshati Strelce Njesia Administrative Gore

Bashkia Maliq

Nr.	Nr. AN	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSI	SASI	ÇMIMI	VLERA
		PUNIME ÇATIE				
1	2.292	Trare tavani te sharuar	m^2	100	456.3	45,626.0
2	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla marseleze	m^2	120	3826.7	459,204.0
3	2.64/2	Mur me tulle te plote llac i perzier M25(parapet,oxhak)	m3	3	20021.0	60,063.0
4	2.203	Veshje kornize me llamarine xingato (impjuver dhe oxhakë)	m^2	4	2036.6	8,146.2
5	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	ml	46	1196.0	55,014.6
		PUNIME SUVATIMI				0.0
1	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m^2	60	2806.7	168,402.0
2	2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah llaç të përzier M 25	m^2	96	1052.9	101,073.6
		PUNIME DYER DHE DRITARE				0.0
1	3.395	Dritare duralumini plastik	m^2	8	11343.5	90,747.8
2	2.388/1	FV dyer të brendshme tamburate të rimesuara	m^2	6	13985.8	83,914.6
		PUNIME BOJATISJE				0.0
1	2.399	Sherbetosje me gelqere	m^2	180	48.0	8,640.0
		PUNIME ELEKTRIKE				0.0
1	2.490/b	F.V. Kasete plastike KE me 6 modular (vende)	copë	1	1220.9	1,220.9
2	2.487	F.V.Kuti shperndarese me kapak me vida PT-2	copë	4	179.8	719.1
3	2.480/2	F.V. Tubo freksibel i bute Ø 20 ÷ 21 mm	ml	20	177.5	3,550.4
4	2.482/1	F.V. Percjelles petashuk PVC Ø 2 x 1.5mm2	ml	10	121.9	1,218.6
5	2.481/1	F.V. Percjelles bakri PVC 1.5mm	ml	40	39.0	1,559.6
6	2.481/2	F.V. Percjelles bakri PVC 2.5mm	ml	40	55.9	2,234.0
7	2.486	F.V. Portollampa normale 10A	copë	4	298.4	1,193.8
8	2.487/c	F.V. Kuti suport pllaket 2 modular	copë	2	321.8	643.7
9	2.485/1	F.V. Çeles ndriçimi 1P 10A 250V	copë	2	593.3	1,186.5
10	2.485/g	F.V. Priza shuko universale 2P+T 16A 250V,	copë	3	649.9	1,949.6
11	2.490/1a	F.V. Automat 2P, 220V, 10A	copë	1	1235.1	1,235.1
12	2.490/1b	F.V. Automat 2P, 220V, 16A	copë	1	1510.70	1,510.7
		SHUMA				**1,099,053.8**
		Vlera e shlyerjes se demit prej 50%				549,526.9

Preventivi është hartuar mbështetur në Manualet e vitit 2024

Preventivoi: Ing.Marjana ZHULI

KOMISIONI I VLERESIMIT

Ilirjan Islamaj

Marjana Zhuli

Rodjan Mara

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË MALIQ
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Maliq, më 16.06.2025

3201

Preventiv

Preventivi i dëmit në orendi dhe pajisje të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën, objekt banimi një katësh te z. Vilaet Ferataj, banues në fshatin Strelcë, Nj. Administrative Gorë - të cilit i'u dogj banesa si pasojë e rënies së zjarrit më datën 07.06.2025

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi(lekë)	Shuma
1	Divane	Copë	5	30.000	150.000
2	Sobë me gaz	Copë	2	20.000	40.000
3	Karrige të zakonshme	Copë	5	4000	20.000
4	Lavatrice	Copë	1	25.000	25.000
5	Tavolinë Buke	Copë	1	20.000	20.000
6	Televizor	Copë	1	22.000	22.000
7	Kolltuk dopjo	Copë	2	15.000	30.000
8	Frigorifer	Copë	1	35.000	35.000
9	Krevat dopio (dhomë gjumi)	Copë	2	30.000	60.000
10	Bufe kuzhine	Copë	1	10.000	10.000
Totali					**412,000**

Çmimet e orendive dhe pajisjeve i janë referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2016 dhe 2023.

Komisioni:

1-Ilirjan Islamaj

2-Marjana Zhuli

3-Rodjan Mara

KRYETARI BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr.304 Prot. Maliq, më 13.06.2025

Procesverbal-Konstatimi

I mbajtur në datën 13.06.2025 në banesën e z. Vilaet Ferataj, banues në fshatin Strelcë, Nj. Administrative Gorë , në zbatim të Urdhërit të Kryetarit nr. 282, datë 12.06.2025, komisioni i konstatimit të gjendjes shkoi në banesë ku konstatoi se ishte djegur plotësisht objekti i banimit një katësh dhe për pasojë pati dëme të konsiderueshme nga ana materiale si dhe në orendi dhe pajisje elektro-shtëpiake si më poshtë:

a-DËME NGA ANA NDËRTIMORE	**b-DËME NË ORENDI DHE PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE**	
1. Punime Suvatimi	- Karrige, cope 5,	-Krevat dopjo, cope 2
2. Punime Dyer /dritare	- Kolltuk dopjo, cope 2,	-Bufe Kuzhine, cope 1
3. Punime Bojatisje	- Divanë, copë 5	-Televizor, cope 1
4.Punime Çatie	- Stof me gaz, copë 2	-Lavatriçe, cope 1
5. Punime Elektirke	- Tavoline buke, cope 1	
	- Frigorife, cope 1	

Komisioni

*1.*Stiljan Belishta

*2.*Nazmi Qose

*3.*Murat Agolli

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 3187 Prot Maliq, më 12.6.2025

URDHËR

Nr. 282, Datë 12.6.2025

PËR
NGRITJEN E KOMISIONEVE TE KONSTATIMIT TË GJËNDJES DHE VLERËSIMIT TË DËMEVE NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Z. VILAET FERATAJ, FSHATI STRELCË, NJËSIA ADMINSTRATIVE GORË"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 64 "Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë", gërma "a", Ligjit Nr. 45/2019 *"Për mbrojtjen civile"*, neni 30, gërma "gj", VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"*, Kreu III, pika 1 "Procedura e vlerësimit të dëmeve" germa "b", për evidentimin e gjendjes së krijuar nga rënia e zjarrit në datën 07.06.2025, në banesën e Z. Vilaet Feratai, banues në Fshatin Strelcë, Njësia Administrative Gorë,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Konstatimit të Gjëndjes dhe Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve për evidentimin e situatës nga rënia e zjarrit në shtëpinë e Z. Vilaet Feratai, Fshati Strelcë, Njësia Administrative Gorë, me përbërje si më poshtë:

Komisioni i Konstatimit	**Komisioni i Vlerësimit**
a) Stiljan Belishta	a) Ilirjan Islamaj
b) Nazmi Qose	b) Marjana Zhuli
c) Murat Agolli	c) Rodjan Mara

2. Komisionet të hartojnë proces-verbalet e konstatimit të dëmeve dhe vlerësimit të dëmeve të shkaktuara, për tja bërë prezent Këshillit të Bashkisë.

3. Të njoftohet Sektori i Mbrojtjes Civile pranë Prefekturës së Qarkut Korçë.

4. Të plotësohet dosja përkatëse me gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji duke ndjekur hap pas hapi ecurinë e problemit.

5. Për zbatimin e ketij urdhëri ngarkohen komisionet e ngritura ne pikën 1 të ketij urdhëri.

6. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ